



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 392/1 Prot

Tiranë, më 03/3/2021

VENDIM

Nr. 14, datë 03.3.2021

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 392 Prot., datë 24.02.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Me shkresën datë 18.11.2020, ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik informacion lidhur me fëmijët e lindur nga viti 2016 deri në fund të vitit 2018, të cilët ende nuk kanë marrë 5 mijë lekë shpërblim nga bashkitë e Qarkut Dibër (Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër), si më poshtë vijon:

1. Pse nuk janë lëvruar këto fonde ndaj pushtetit vendor?
2. Nëse do të lëvrohen, kur do të ndodh kjo?
3. Meqë prej Janarit të vitit 2019 jepen rregullisht shpërblimet për lindjen e fëmijëve (i pari 40 mijë lekë, i dyti 80 mijë lekë dhe i treti 120 mijë lekë të rinj) e nuk jepen 5 mijë lekë të rinj për fëmijët e lindur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri?

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstaton se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar në pikën 2, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon se: *“Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.”*

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa e z. _____ ndaj Autoritetit Publik është paraqitur përtej afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si e tillë nuk mund të merret në shqyrtim.

Gjithashtu, pavarësisht afatit, referuar legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstatohet se ankesa është jashtë objektit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ndërkohë kërkesa e paraqitur nga ankuesi lidhet me shprehjen e qëndrimit të Autoritetit Publik mbi një çështje të caktuar në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale dhe veprimtarisë së këtij të fundit.

Bazuar në pikën 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikohet se: *“informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*. Në këtë kuptim, mund të kërkohet çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga autoriteti publik dhe jo një veprim që lidhet me detyrën funksionale të këtij të fundit.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Mospranimin e ankesës nr. 392 Prot., datë 24.02.2021 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 03 . 3 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

